



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 21.04.2017, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Flamur Shala (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Shefqet Sylejmani (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hetem Kupina (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Berat Lahu (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Sami Boroci (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësues e subjektit politik (LB), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo (KDTP).

Munguan: Shaip Shabani (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), dhe Abit Kastrati.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues, i cili e hapi diskutimin për rendin e ditës.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se në pikën e tetë të rendit të ditës, e kemi një çështje që ndërlidhet me projektin e ENK-së "Raiffaissen". E kemi votuar dy herë në këtë Kuvend, na duhet edhe një vendim i Kuvendit, sepse në vitin 2012 ka ndodhur një këmbim i pronës për ta realizuar atë projekt.

Kryesuesi theksoi se propozimin e kryetarit duhet vendosur në rend të ditës.

Ardian Olluri tha se sa i përket pikës për anulimin e marrëveshjes në mes të Komunës dhe ENK-së, materialet kur të jenë të gatshme do t'i sjellim në Kuvend, ndërsa për këmbim i kemi disa komente.

Qëndron Kastrati propozoi që para pikës për caktimin e aksionarëve të ndërmarrjeve publike, të diskutojmë ose të jetë pikë e rendit të ditës edhe gjendja në ndërmarrjen "Trafikun Urban". Si shef i GP të VV-së, kam pranuar një petition nga punëtorët e ndërmarrjes "Trafiku Urban" dhe më intereson që ta kem një version nga ekzekutivi edhe nga Lirie Avdiu, si anëtare e Komisionit komunal.

Lirak Çelaj tha se në parim është mirë ta diskutojmë këtë pikë, por meqenëse Liria nuk është e pranishme, do të ishte mirë të shtyhej për mbledhjen e radhës, ose ta qesim dhe nëse caktohet, le të hyjë si pikë e nëntë e rendit të ditës.

Agim Gashi ngriti shqetësimin e tij, duke thënë se kur është bërë reagimi që Liraku dhe Agimi kanë bërë përpjekje për futje me dhunë në ndërmarrjen "Trafik Urban", unë kam qenë në fshatin Makoc, duke bërë homazhe. Deklarimet e ngutshme dhe të ndjeshme në këtë aspekt nuk i bëjnë mirë askujt. Unë kisha sugjeruar që të keni kujdes, sidomos me njerëzit që bartin përgjegjësi publike.

Imer Rusinovci tha se në këtë rend të ditës do të duhej të përfshihej edhe caktimi i një komisioni profesional për përcjelljen e gjendjes së kulturave pranverore dhe gjendjen e dëmeve nga temperaturat e ulëta që mbretëruan këto ditë.

Kryesuesi tha se është mirë që Drejtoria e Bujqësisë ta formojë atë komision dhe të na e sjellë një raport për gjendjen e të mbjellave dhe çështjen e bujqësisë në komunën e Prishtinës.

Kryetari, Shpend Ahmeti, i informoi të pranishmit se, sipas një shkrese zyrtare që ka ardhur nga Ministria, gjashtë muaj para mbajtjes së zgjedhjeve lokale, Kuvendi nuk ka të drejtë të marrë asnjë vendim që ka të bëjë me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë dhe jo për këmbim të pronave, por kufizimi është për dhënie të pronës në shfrytëzim afatgjatë, deri më 15 maj. Por, unë propozoj që ta fusim në rend të ditës, në parim në qoftë se nuk ka pengesa ta votojmë, pastaj në qoftë se ka nevojë për përmbushje të dokumentacionit ta bëjmë edhe më tutje.

Flamur Shala ngriti një shqetësim, duke thënë se për çfarë arsye kaq ngutshëm po i procedojmë këto pika të rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi më 27 (njëzet e shtatë) vota për, 4 (katër) vota kundër, (Halim Halim, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Vlora Dumoshi) dhe 4 (katër) abstenime, (Hazir Borovci, Laura Zherka, Muhamet Nura, Shemsi Veseli), u miratua propozimi që anulimi i marrëveshjes me ENK-në të futet në rend dite.

Kryesuesi konstatoi se më 39 (tridhjetë e nëntë) vota për, 1 (një) votë kundër, (Imer Rusinovci) dhe 1 (një) abstenim, (Halim Halimi), hynë në rend dite për diskutim: Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.

Kryesuesi konstatoi se me 39 (tridhjetë e nëntë) vota për, 1 (një) votë kundër, (Imer Rusinovci) dhe 1(një) abstenim (Halim Halimi) u miratua ky

REND I DITËS :

1. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant;
2. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale;
3. Propozimvendimi për ridestinimin e objektit të vjetër të bibliotekës "Hivzi Sylejmani";
4. Propozimvendimi për themelimin e ansamblit të qytetit "Rexho Mulliqi";
5. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A-1 të lagjes "Dodona";
6. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e re" - Zona Lindje;
7. Propozimrregullorja mbi ta kasën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës;
8. Propozimvendimi për anulimin e marrëveshjes me ENK "Invest Group" SHA Prishtinë;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë;
10. Caktimi i një anëtarë në Komisionin Komunal të Aksionarëve në NPL "Hortikultura" SHA, NPK "Trafiku Urban" SHA dhe KRM "Pastrimi";
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Pika e parë

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant.

Ardian Olluri tha se nga Ministria është kthyer vendimi për caktimin e lokacionit, si i kundërligjshëm, me arsyetimin që nuk është në harmoni me dokumentet e planifikimit dhe se është në kundërshtim me Ligjin për planifikim, për shkak se destinimi i sipërfaqeve

bëhet me dokument të planifikimit, jo me vendim për caktim të lokacionit. Lokacioni ku është caktuar për varreza është i planifikuar si gjelbërim, kjo çështje është diskutuar disa herë në Kuvend dhe Kuvendi ka vendosur që të caktohet ai lokacion.

Kryetari, Shpend Ahmeti tha se unë kam pasur takim me Ministrinë dhe me Departamentin e Shtetit amerikan. Kjo çështje është përmendur në raportin e progresit si diskriminim ndaj komunitetit protestant. Edhe Departamenti amerikan i Shtetit në raportet e veta vjetore, për katër vite e përmend që çështja e varrezave të komunitetit protestant duhet të zgjidhet. Unë propozoj që ta mbajmë vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës për varrezat protestante. Përgjigjja e Ministrisë ka ardhur me vonesë dhe këtë mund ta përdorim edhe si arsytim që ky vendim tashmë është publikuar, pra kemi pasur pajtim të gjitha grupeve dhe subjekteve politike.

Agim Gashi tha se derisa vendimi është i plotfuqishëm me automatizëm për shkak të mos reagimit me kohë, nuk ka qenë dashur të silltet propozimi si akt përcjellës, për arsye se është i panevojshëm. Në qoftë se e anulohet tani, ai veç është i plotfuqishëm dhe po marrim një vendim pas kohe, të paarsyeshëm, të panevojshëm, sepse sipas një logjike juridike ky veç është i plotfuqishëm.

Flamur Shala tha se duhet anuluar këtë vendim, në mënyrë që në të ardhmen të vendosim diçka të ligjshme. Nëse Ministria e ka kthyer dhe ka ardhur deri te ne dhe nuk po do ekzekutivi ta marrë përgjegjësinë, pse ta marrim një përgjegjësi ne dhe të kalojmë diçka të jashtëligjshme. Pra, duhet të votojmë pro këtij propozimvendimi, për anulim të këtij vendimi.

Remzi Pacolli tha se në Kuvendin e Komunës është votuar që komisionit për emërimin e rrugëve t'u paguhet puna që e kanë bërë. Kërkesën që e ka bërë Zyra ligjore, prej Ministrisë është kthyer negativ, kinse sipas një rregulloreje ajo është një keqpërdorim që e kanë bërë në nenin për pagesa dhe na është përcjellë neve që nuk mundemi me u paguar, ky vendim nuk po zbatohet. Ndërsa vendimet tjera kundërligjshëm po vazhdojnë me u zbatuar, edhe pse janë kthyer pas afatit të caktuar përgjigjet negative.

Ylli Hoxha tha se asnjë grup parlamentare nuk ka qenë kundër kësaj pike. Nëse është anuluar ky vendim, është dashur ta sjellë brenda afatit ligjor, nuk është rastësi që e kanë sjellë jashtë afatit. Për këtë vendim nuk mendoj që po bëhet ndonjë ndryshim drastik në Planin hapësinor. Trajtimi i një hapësire të gjelbër në varreza, është prapë hapësirë e gjelbër. Mendoj që duhet t'i hapim rrugë atij vendimi që e morëm bashkërisht në mbledhjen e kaluar.

Lirak Çelaj shprehu mendimin që të hiqet kjo pikë e rendit të ditës dhe ai vendim të mbetet në fuqi.

Kimet Zeqa pyeti se pse nuk janë të gjitha varrezat në një vend, të hebrenjve dhe të protestantëve, sepse besoj që ka hapësirë të mjaftueshme. Unë kam biseduar se mundet me qenë vetëm në një vend me komunitetet tjera hebrenjve, katolikëve, jo me u marrë prona që është caktuar për gjelbërim dhe të jepet për varreza protestante.

Berat Lahu tha se në mënyrë procedurale, kryetari e ka obligim ligjor me e prurë në asamble këtë vendim që na me e refuzuar. Ky vendim është sjellë në Kuvend dhe ne sot duhet me e refuzuar anulimin e vendimit, me mbetur vendimi në fuqi dhe me vazhduar tutje.

Sadri Ramabaja tha se ky vendim parimisht duhet të votohet kështu siç e shpjegoi edhe Berati, sepse e obligon ligji, tash është çështje e jona se a e votojmë a jo. Unë po ju them që prapë abstenoj, sepse nuk jam për ndarjen e varrezave të shqiptarëve.

Sami Boroci ceku se edhe ne si GP, jemi që ky vendim të mbetet në fuqi.

Shemsi Veseli tha se këtë vendim e kemi votuar në Kuvend dhe gjithmonë ekziston ajo tendenca që e mori përgjegjësinë Kuvendi dhe Kuvendi duhet me e hequr atë përgjegjësi. Prandaj unë, parimisht po flas, nuk do të votoj.

Hetem Kupina u thirr në zbatimin e ligjit, dhe tash e tutje t'i përmbahemi asaj rregulle.

Ylli Hoxha tha se për ta vërtetuar a ka shkelje të ligjit apo jo, duhet të shkohet në gjykatë dhe gjykata ta konstatoj shkeljen e ligjit.

Kryesuesi konstatoi se më 28 (njëzet e tetë) vota për, 4 (katër) vota kundër, (Abetare Fazliu, Hetem Kupina, Muhamet Nura, Shaip Hajrizi) dhe 8 (tetë) abstenime (Besa Rafuna, Flamur Shala, Kimet Zeqa, Merita Surkishi, Naime Osmani, Qendron Kastrati, Sadri Ramabaja, Vlora Dumoshi) mbetet në fuqi Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat e komunitetit protestant.

Pika e dytë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Muhedin Nushi, drejtori i Drejtorisë së Administratës, tha se ndryshimet kanë të bëjnë me tri tarifat e fundit, për ceremoninë e kurorëzimit jashtë objektit të Komunës, për certifikatat nga E-qoshku, i cili është si produkt i ri në kuadër të Zyrës së gjendjes civile, i cili nuk ka qenë i përfshirë në këtë rregullore për tarifa, dhe për ceremoninë e mbjelljes së drurit të martesës, i cili do të jetë produkt i ri, që do të fillojë të zbatohet në muajin maj të këtij viti.

Agim Gashi tha se do të ishte mirë të dihet ku është lokacioni i mbjelljes së drurëve të martesës.

Shefki Gashi pyeti, se ku bëhet pagesa, a ka emra të personave të qiftit bashkëshortor ai dru, të paktën një kohë duhet me pas një numër, me pas një diçka që lidhet me kurorëzimin? A duhet me marrë pjesë në mbjelljen e pemës, kanë me zgjedhur çfarë peme, çfarë druri duhet të mbillet?

Fadil Gashi tha se, siç dihet këtu në Prishtinë martesat bëhen shpesh, po a kanë drurë dhe vend ku do të vendosin ato qifte ata drurë?

Ylli Hoxha theksoi se ky projekt ka me zgjuar interesim, sidomos te moshat e shtyra, dhe e inkurajoj Komunën që të planifikojë edhe ceremoninë e mbjelljes së drurit të përvjetorit të martesës, 10 vjetorit, 20 vjetorit, sepse po më duket që kemi shumë interesim për këtë punë.

Sami Boroci tha se po e përshëndesim si grup këtë projekt të ri, dhe mendojmë që do t'i kontribuojë edhe rritjes së hapësirave gjelbëruese në qytet.

Vlora Dumoshi theksoi se kjo është nismë shumë e mirë dhe unë e përgëzoj drejtorin për këtë.

Abetare Fazliu tha se përkrahim këtë ndryshim dhe plotësim të rregullores.

Qëndron Kastrati pyeti se zyrtarët që angazhohen për këto shërbime jashtë orarit të punës, a kanë kompensim të veçantë për këtë punë.

Sylejman Pireva shprehu mendimin se gravura që do t'u vihet emrave të bashkëshortëve, qiftit, donë edhe një mbrojtje pastaj, sepse dikush në mënyrë tendencioze mund të shkojë ta prish atë gravurë.

Sadri Ramabaja tha se ideja është e mrekullueshme, por duhet t'ia bëjmë me dije drejtorit se nuk e ka origjinalin, origjinali ka qenë i Skënderbeut, me një ulli dhe një bli.

Për pyetjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit rreth çështjes së kurorëzimit, **Muhedin Nushi** dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi ceku se para se të votojmë, vetëm një plotësim në vendim, pika 2 e vendimit, do të thotë neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, ndryshon dhe plotësohet.

Kryesuesi konstatoi se më 40 (dyzet) vota për, unanimitisht u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.

Pika e tretë

Propozimvendimi për ridestinimin e objektit të vjetër të bibliotekës "Hivzi Sulejmani".

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se ne kemi menduar që objektin e vjetër të bibliotekës "Hivzi Sulejmani", ta kthejmë në muze dhe në qendër edukativo-arsimore "Ibrahim Kodra", ku do të vendosej në mënyrë të përhershme koleksioni i pikturave të këtij piktori të madh shqiptar.

Agim Gashi tha se ne si GP kemi propozuar të ruhet një degë e bibliotekës "Hivzi Sulejmani", në një pjesë të objektit, sepse aty janë dy objekte, njëri të shfrytëzohet për bibliotekë dhe tjetri për një qendër kulturore të mundshme, që të mos e kufizojmë vetëm me një lloj veprimtarie artistike, por të jetë pak më shumë përfaqësuese.

Qëndron Kastrati theksoi se ne si grup e përkrahim këtë ide.

Lirak Çelaj tha se kur është në pyetje emri i Ibrahim Kodrës, është nder për qytetin e Prishtinës me i pas punimet e tij. Mendoj se sa i përket emërtimit të këtij institucioni dhe veprimtarisë, unë jam që kjo me u quajtur galeri, jo qendër edukativo-artistike. Po ashtu desha ta dijë se a do të jetë OJQ apo do të jetë një ndërmarrje shtetërore, kështu që ne në parim e përkrahim.

Sami Borovci edhe ne si GP e përkrahim.

GP i AAK-së e përkrahu këtë pikë të rendit të ditës

Kimet Zeqa në parim e përkrahim dhe është nder për qytetin tonë t'i kemi pikturat e artistit të njohur.

Abetare Fazliu tha se edhe ne si LB e përkrahim këtë vendim.

Hatixhe Latifi - Pupovci ngriti një shqetësim, duke thënë se përkundër faktit që pajtohem me të tjerët rreth një objekti me pikturat e Ibrahim Kodrës, desha të pyes se a ka në atë lagje ndonjë bibliotekë, sepse ajo ka qenë biblioteka e vetme në atë pjesë të qytetit, aty është afër shkolla dhe nuk e di a është mirë që një objekt i cili ka qenë bibliotekë, të mos jetë më bibliotekë.

Vlora Dumoshi ceku se sa i përket emërtimit, duhet të kemi kujdes, do ta quajmë muze, apo do ta quajmë galeri. Po ashtu, gjendja aty është jo e mirë, ka lagështi, kur dihet se piktura është mjaftë e ndjeshme.

Shefki Gashi tha se jam kundër mbylljes së bibliotekës. E përkrahi nëse është ai testament, me e ditur atë testament me e nda në një lokacion diku, me u ndërtuar një galeri e veçantë, diçka të bukur që i takon tamam kohës, tamam qytetit.

Sylejman Pireva tha se patjetër duhet t'i gjendet një lokacion bibliotekës së ardhshme, si degë e bibliotekës "Hivzi Sulejmani", tani që është në Dardani. Siç po bëjmë përpjekje të kemi në çdo lagje ambulanca, të kemi çerdhe, të bëjmë përpjekje në të ardhmen të shtrijmë rrjetën e bibliotekës nëpër çdo vend.

Ylli Hoxha tha se sa i përket ndarjes së mjeteve, nuk kemi nevojë të ndajmë mjetet tona për rinovim të objektit. Por duhet të jemi pragmatik, kemi 700 mijë euro që janë në dispozicion, kemi një vlerë akoma më të madhe të pikturave që na jepen dhe mendoj që ia vlen ta bëjmë këtë votë vetëm në këtë aspekt.

Sadri Ramabaja tha se mendimi imë është që të formohet një komision i përgjegjshëm, që do të mund të jepte një propozim për një ndërtim të një galerie me emrin e tij, është një nder i madhe në qytetin ku jetojmë. Çështja është se, meqë janë ato 700 mijë euro, me atë shumë lehtë mund ta bënim një Galeri nga zeroja, me stil dhe mënyrë të jetesës së pikturës dhe të veprës së Ibrahim Kodrës, sesa të bënim improvizime të kësaj natyre me Bibliotekë.

Ajnishahe Azemi shprehu mendimin se biblioteka nuk duhet të ridestinohet, por duhet të mbetet, sepse i kontribuon zhvillimit të mirëfilltë të identitetit të qytetarëve tonë, fëmijëve tonë. Mirëpo duke e pas parasysh se flasim për Ibrahim Kodrën, piktorin tonë të famshëm, është mirë të gjendet mundësia të ndërtohet objekti për pikturat e tij dhe për aktivitete tjera. Po ashtu, mendoj se Kuvendi komunal duhet të vendosë se a do të jetë institucion komunal, apo të jetë OJQ.

Bardha Dida-Rogova, tha se unë nuk pajtohem që duhet me u ndërtuar objekt i ri, duhet ti vëmë në funksion objektet e vjetra ekzistuese dhe t'i renovojmë ato. Gjithashtu edhe ky objekt tash nuk e ka funksionin e bibliotekës, është shumë i amortizuar. Po ashtu, këndet e leximit nëpër shkolla nuk mjaftojnë, duhet të kemi edhe biblioteka në lagje, por ky ka me qenë sigurisht projekt në vitet e ardhshme. Unë mendoj që patjetër duhet që veprat e Ibrahim Kodrës të ekspozohen diku, andaj ta aprovojmë.

Besart Vllahinja, Drejtori i Drejtorisë së Kulturës, theksoi se objekti vazhdon të mbetet në pronësi të Komunës. Hapi për të cilin po diskutojmë ne ka të bëjë vetëm me ridestininimin prej një hapësire e dedikuar për bibliotekën e mëparshme, në një Qendër kulturore, edukativo-artistike dhe mendoj që ka vend me u diskutuar edhe emërtimi i saj.

Kryesuesi konstatoj se më 20 (njëzet) vota për, 18 (tetëmbëdhjetë) vota kundër, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Fisnik Osmani, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Hatixhe Latifi - Pupovci, Hazir Borovci, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Mustafë Krasniqi, Naime Osmai, Sadri Ramabaja, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shefqet Sylejmani, Teuta Krasniqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Vlora Dumoshi), u miratua Vendimi për ridestininimin e objektit të vjetër të bibliotekës "Hivzi Sulejmani".

Pika e katërt

Propozimvendimi për themelimin e ansamblit të qytetit “Rexho Mulliqi”.

Besart Vllahinja, Drejtori i Drejtorisë së Kulturës, tha se duke u bazuar në Ligjin për institucionet e Kulturës dhe në Ligjin për ansamblin “Shota” dhe ansamblet tjera, po synojmë në krijimin e një institucioni të ri të kulturës, gjegjësisht ansamblin e qytetit. Ideja jonë është që ansambli i ardhshëm i kryeqytetit të ketë tri seksione: seksionin e këngëve, valleve dhe të orkestrës. Ideja është me funksionalizuar një institucion të ri, i cili i mungon Prishtinës.

Agim Gashi tha se GP i LDK-së mendon se materiali nuk është i kompletuar, pra nuk është cekur ajo që është kërkuar në Komitet për Politik dhe Financa në arsyetim, duke përfshirë edhe koston e këtij projekti, pastaj selinë e projektit dhe karakteristikat tjera.

Prandaj, ne kërkojmë që kjo të shtyhet për një seancë tjetër, të kompletohet lënda dhe pastaj të ulemi dhe të diskutojmë.

Qëndron Kastrati tha se ne mendojmë që është ide shumë e qëlluar që kryeqyteti të ketë një ansambël të tillë, andaj dhe do ta përkrahim.

Lirak Çelaj cekur se është një projekt i paanalizuar si duhet dhe i perealizueshëm, unë nuk jam në parim për të realizuar një çështje të tillë.

Sofije Bunjaku theksoi se ne si grup parlamentar kemi biseduar dhe e shohim të arsyeshme që të ekzistojë një ansambël i tillë.

Rita Begolli, në emër të grupit tha se është një iniciativë shumë e qëlluar themelimi i ansamblit të qytetit “Rexho Mulliqi”.

Vlora Dumoshi kërkoi disa sqarime nga Drejtori i Kulturës për themelimin e ansamblit “Rexho Mulliqi”. Ajo kërkoi ta dijë se ku do ta ushtrojë veprimtarinë ky institucion, cilat janë shpenzimet për fillimin e punës për angazhimin e instrumentistëve, a do të jenë me kontratë apo shërbyes civilë, sa do t’i kushtoj ky ansambël Komunës së Prishtinës etj.?

Bardha Dida - Rogova nuk u shpreh e pajtimit për themelimin e këtij ansambli, duhet të përgatitet një plan pak më konkret se çka mundemi me bërë.

Ndoshta një propozim i imi është që në shkollat e komunës së Prishtinës të ketë një orkestër modeste, me blokflauta dhe me instrumente të tjera.

Kryesuesi tha se nëse themelojmë diçka, duhet një elaborat i tërë e jo vetëm një letër qysh e kemi ne këtu. Besoj se nuk jemi të përgatitur që ta shqyrtojmë këtë çështje.

Ylli Hoxha theksoi se, nëse në parim jemi dakord me bërë ansambël të qytetit, ekzekutivi mundet me ia dal financiarisht me e rregulluar këtë çështje.

Sylejman Pireva shprehu mendimin që në parim të kalojë kjo pikë. Dihet se ky projekt nuk është aq i thjeshtë dhe kjo ide kërkon mjaft punë. Kuvendi nëse nuk arrin në të ardhmen, përmes punës që bënë drejtorja, me na bindur se kjo është e ligjshme, e nevojshme dhe e domosdoshme, atëherë ne nuk do ta përkrahim më tutje.

Naime Osmani tha se dua ta dijë që këto tri vjet e gjysmë sa shoqëri kulturore artistike janë në komunën e Prishtinës dhe sa i keni mbështetur ato. Mendoj që në këtë ansambël është dashtë të kyçen ata anëtarë që kanë përvoja në të kaluarën, sepse duhet ta njohin mirë traditën sidomos të këngëve dhe valleve popullore.

Ajnishahe Azemi theksoi se kjo pikë duhet të shtyhet dhe të na vij gjithçka e qartësuar.

Berat Lahu tha se drejtori nuk mundet me marr kurrfarë hapi për me themeluar këtë ansambël pa ia dhënë ne vendimin e themelimit. Besoj se është punuar në atë drejtim, është menduar gjatë për themelimin e një ansambli të tillë dhe na është sjell ky vendim në Kuvend.

Shefki Gashi bëri vërejtje rreth hartimit të vendimit, duke thënë se është dashtë të jetë më i kompletuar.

Kryesuesi konstatoj se më 19 (nëntëmbëdhjetë) vota për, 20 (njëzet) vota kundër, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Egzona Podvorica, Fisnik Osmani, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Hazir Borovci, Hetem Kupina, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shefqet Sylejmani, Shemsi Veseli, Vlora Dumoshi), nuk u miratua Propozimvendimi për themelimin e ansambllit të qytetit "Rexho Mulliqi".

Pika e pestë

Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A-1 të lagjes "Dodona".

Ardian Olluri tha se këto vendime kanë kaluar në Kuvend, por Ministria është vonuar në dhënien e mendimit, edhe janë publikuar aktet dhe kanë hyrë në fuqi. Këto pika janë sjellë për diskutim për me e informuar Kuvendin, ku ne kemi mbajtur takim me përfaqësuesit e Ministrisë edhe i kemi diskutuar komentet për shkak se komentet sot ju kemi sjell edhe faqen e Ligjit ku janë bazuar. Komentet nuk kanë të bëjnë fare me aktin që është miratuar në Kuvend. Edhe në takimin me Ministrinë është sqaruar dhe e kemi kuptuar që ka qenë një gabim teknik, d.m.th. kjo ka ardhur gabimisht, komentet kanë qenë për një akt tjetër dhe kanë ardhur gabimisht për këtë akt.

Agim Gashi tha se GP i LDK-së mban qëndrimin që e ka pas deri më tash, d.m.th. të mos merr një vendim, çfarëdo vendimi që ka të bëjë me këto çështje, pa nxjerrjen e hartave zonale sepse është në kundërshtim me ligjin.

Qëndron Kastrati tha se ne do ta përkrahim në parim këtë propozimvendim, sepse është vendim për fillimin e hartimit të Planit rregullues, vetëm se ju kërkohet që kjo të jetë në përputhje me Planin zhvillimor urban dhe gjithashtu në raport me një vendim apo aprovim konsensual të Kuvendit, që kjo hapësira përpara të parashihet ose të jetë park.

Lirak Çelaj tha se jemi vënë në pozitë të keqe, sepse vazhdimisht vijne planet e njëjta të cilat edhe kthehen. Më duket se është dashur të jetë një trajtim më serioz, më gjithëpërfshirës, së bashku me Ministrinë me kuptuar se ku është problemi dhe a mundemi dhe çka mundemi me bërë me këto plane.

Grupi parlamentar i AKR-së, i AAK-së, i LB-së dhe i PD-së e përkrahën këtë propozimvendim për miratim.

Kryesuesi konstatoi se më 21 (njëzet e një) vota për, 3 (tri) vota kundër, (Halim Halimi, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi) dhe 10 (dhjetë) abstenime, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Fisnik Osmani, Hazir Borovci, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Mustafë

Krasniqi, Naime Osmani, Shefqet Sylejmani), u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm të bllokut A-1 të lagjes “Dodona”.

Pika e gjashtë

Propozim vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane “B” të lagjes “Prishtina e Re - Zona Lindje”

Kryesuesi konstatoi se më 21 (njëzet e një) vota për, 3 (tri) vota kundër, (Halim Halimi, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi) dhe 10 (dhjetë) abstenime, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Fisnik Osmani, Hazir Borovci, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Shefqet Sylejmani), u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane “B” të lagjes “Prishtina e Re - Zona Lindje”.

Pika e shtatë

Propozim rregullorja mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës

Ardian Olluri tha se këtu është kërkuar që të taksa për ndërtimin e infrastrukturës, të mos jetë e caktuar tarifa fikse, mirëpo kjo të vlerësohet sipas investimeve që duhen me u bërë në terren për me e ndërtuar infrastrukturën. Ndryshimet janë bërë në nenin 10 dhe nenin 11 të rregullores, pra është larguar tarifa fikse, është lënë që kostoja e ndërtimit të caktohet në bazë të vlerësimit me marrëveshje në mes të Komunës dhe investuesit.

Mustafë Krasniqi tha se edhe GP i LDK-së këtë propozimrregullore e ka shqyrtuar dhe analizuar dhe në parim jemi që të kalojë kjo, edhe pse po e them tash se edhe në të kaluarën çdo rregullore apo çka do që e kemi pas përpara e ka pasur një arsyetim.

Lirak Çelaj tha se GP i PDK-së nuk e përkrah që të kalojë kjo rregullore, me arsyetimin se konsiderojmë që krejt këto taksa kanë ndikuar në rritjen e kostos së njërive banesore. Mendojmë se kjo vetëm do ta ngarkojë edhe më shumë qytetarin, prandaj ne në parim jemi kundër.

Grupet parlamentare të LVV-së, AAK-së, AKR-së, PD-së dhe LB-së, e përkrahën Propozimrregulloren për miratim.

Kryesuesi konstatoi se më 26 (njëzet e gjashtë) vota për, 8 (tetë) vota kundër, (Egzona Podvorica, Halim Halimi, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Muhamet Nura, Shefqet Sylejmani, Shemsi Veseli, Vlora Dumoshi) dhe 2 (dy) abstenime, (Agim Gashi, Ylli Hoxha), u miratua Rregullorja mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Pika e tetë

Propozimvendimi për anulimin e marrëveshjes me ENK “Invest Group” SHA Prishtinë

Arsyeshmërinë për anulimin e kësaj marrëveshjeje e dha **Ardian Olluri**, i cili tha se në vitin 2012 është arritur një marrëveshje në mes të Drejtorisë së Pronës dhe ENK-së për rregullimin

e kufijve, ku në fakt është bërë një këmbim i pronave në kufi të parcelave private me të Komunës. Pastaj këtu në Kuvend, i cili është bërë në bazë të Planit rregullues, është ndryshuar traseja, është ndryshuar Plani rregullues dhe realizimi i kësaj marrëveshje është bërë i pamundur, arsyeja pse është bërë ky rregullim më nuk ekziston. Pala, përkatësisht investitori ka bërë kërkesë që të anulohet marrëveshja, sepse nuk ka më planifikim për interes publik në atë pjesë e cila ju ka marr ENK-së.

Shemsi Veseli tha se është për tu habitur se si po na sillen lëndët tash për tash, pa i analizuar mirë, që ka të bëjë me këmbim të pronave dhe me i votuar ato. Mendoj se është një përgjegjësi shumë e madhe për secilin për neve, pavarësisht që asnjëri prej kolegëve këtu nuk është për me e godit interesin publik. Por, gjithmonë d.m.th. ka qenë një vullnet brenda këtyre që kolegët të votojnë.

Unë mendoj që në këto vendime duhet një arsyeshmëri shumë më e madhe, me qenë sa më të qarta e të mos vijmë para dilemave të tilla. Unë do të jem kundër këtij propozimi dhe nuk do ta votoj.

Kryesuesi konstatoj se më 27 (njëzete shtatë) vota për, 4 (katër) vota kundër, (Halim Halimi, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Vlora Dumoshi) dhe 4 (katër) abstenime, (Hazir Borovci, Laura Zherka, Muhamet Nura, Shemsi Veseli), u miratua Vendimi për anulimin e marrëveshjes me ENK-në "Invest Group" SHA Prishtinë.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës me pronat e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.

Ardian Olluri tha se arsyeja që janë tërhequr nga pika e rendit të ditës këto materiale, është se nuk kemi qenë të sigurt lidhur me pronën komunale, për statusin e saj. Po ashtu informacioni që ka ardhur materialet që i kemi marr prej drejtorive, nuk kanë qenë shumë të detajuara. Fletat poseduese që i kemi marrë pronat komunale janë të kategorizuara si infrastrukturë rrugë, ndërsa këmbehen me prona private, për të cilat nuk sqarohet se për çka, për interes publik po, por çfarë projekti i cili nuk ka sqarim të detajuar.

Andaj, si sektor ligjor nuk mundem me e konfirmuar sot që këto janë në pajtueshmëri me ligjin, nëse këto kalojnë sot, pastaj prapë ka mundësi nëse është bërë ndonjë gabim me u përmirësuar, për shkak se shkojnë në Ministri dhe Ministria e vlerëson ligjshmërinë.

Agim Gashi tha se ne pajtohemi që këto dy lëndë të procedohen d.m.th. të votohen nëse i fitojnë votat dhe, që tha shefi i Zyrës ligjore, nëse vërehet ndonjë lëshim i mundshëm, meqenëse është marr interpretimi i AKP-së dhe aty nuk është kontestuar, nuk kanë ndonjë evidencë se ato janë pronë e dikujt tjetër përpos e Komunës.

Shemsi Veseli tha se ne si GP nuk do ta votojmë këtë pikë, me arsyetimin se proceduralisht nuk janë sqaruar ashtu si duhet. Qysh mundet me u proceduar një çështje pa e pasur të qartë tamam statusin e pronës?!

Kryesuesi konstatoi se me 26 vota për, 5 (pesë) vota kundër (Egzona Podvorica, Fadil Gashi, Laura Zherka, Shefqet Sylejmani, Shemsi Veseli) dhe 4 (katër) abstenime (Baradha Dida - Rogova, Muhamet Nura, Rita Begolli, Sylejman Pireva), u miratua Vendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës me pronat e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.

Pika e dhjetë

Caktimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve të NPL "Hortikultura" SHA, NPK "Trafiku Urban" SHA, dhe KRM "Pastrimi".

Agim Gashi, në emër të GP të LDK-së, për anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve për NPK "Trafiku Urban", propozoi Hetem Kupinën, ndërsa për KRM "Pastrimi", propozoi Shefqet Sylejmanin.

Lirak Çelaj, në emër të GP të PDK-së, për anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve të NPL "Hortikultura", propozoi Egzona Podvoricën.

Qëndron Kastrati në emër të GP i LVV-së, për anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve në NPL "Hortikultura", propozoi Sami Borocin, për NPK Trafiku Urban", Visar Arifajn dhe për KRM "Pastrim" Fadil Gashin.

Kryesuesi konstatoi se për Hetem Kupinën ishin 21 vota për, ndërsa për Visar Arifajn 14 vota.

Kryesuesi konstatoi se Hetem Kupina caktohet anëtar në Komisioni Komunal të Aksionarëve në NPK "Trafiku Urban".

Kryesuesi konstatoi se për Egzona Podvoricën ishin 21 vota për, ndërsa për Sami Borocin 13 vota për.

Kryesuesi konstatoi se Egzona Podvorica caktohet anëtare e Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL "Hortikultura".

Pas këtij votimi, GP i LVV-së, GP i AAK-së, GP i AKR-së, përfaqësuesi i subjektit politik të KDTP-së dhe përfaqësuesi i subjektit politik GIS, e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi konstatoi se në mungesë të kuorumit, mbledhja ndërpritet.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20

Procesmbajtësja
Luljeta Selimi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dip.

